KRONIKË E ZEZË

Djali e kërcënoi me vrasje nënën e tij në Prishtinë

11 prill 2023, 09:16

Shpërndaje në

Policia e Kosovës i ka regjistruar pesë raste të dhunës në familjes gjatë 24 orëve të fundit. Një person u arrestua në Prishtinë të hënën, me dyshimin se pasi iu kishte kërkuar para prindërve, i ka fyer dhe ofenduar, duke shkaktuar frikë te viktimat.

Autoritetet policore njoftuan se të dyshuarit i është ofruar trajtim mjekësor në klinikën e psikiatrisë, por më pas është liruar mjeku, për t'u dërguar në mbajtje.

Policia njoftoi se në Prishtinë janë regjistruar edhe dy raste të tjera të dhunës më 10 prill. Në njërin rast, një grua ka raportuar se është kërcënuar me vrasje nga djali i saj. I dyshuari është arrestuar dhe pas intervistimit është dërguar në mbajtje.

Ndërsa, Policia njoftoi se një grua derisa po shkonte te ish-bashkëshorti për t'i ushqyer fëmijët, ishte sulmuar fizikisht nga i dyshuar . Ajo ka pranuar trajtim mjekësor, e i dyshuari gjendet në arrati.

Në qytetin e Obiliqit, një grua dhe një burrë kanë shkaktuar dhunë në familje.

"Palët janë intervistuar dhe me vendim të prokurorit, rasti në procedurë të rregullt", njoftoi Policia.

Policia bëri të ditur se edhe në Prizren është regjistruar një rast i dhunës në familje. Një grua u ankua se bashkëshorti e ka sulmuar fizikisht.

"Po ashtu viktima ka njoftuar se bashkëshorti i saj posedon edhe armë dhe municion. Njësitë relevante policore kanë gjetur dhe sekuestruar një AK47 me një karikator dhe 420 fishekë si dhe një revole me dy karikatorë dhe 176 fishekë. Viktimës iu është ofruar tretman mjekësor. I dyshuari nuk është hasur nga policia dhe është në kërkim policor, rasti vazhdon të hetohet", thuhet në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#POLICIA E KOSOVES #ARRESTIM #DHUNE NE FAMILJE

Arrestohen dy serbë në veri për "vjedhje të rëndë në tentativë"

Një i dyshuar në Kllokot e rrahu e pastaj e rrëmbeu me forcë ish-të dashurën

Gjendet i vdekur një person në Gjakovë

Tre të lënduar nga rënia e ashensorit në Emshir të Prishtinës

Arrestohet djali në Prizren për dhunë të vazhdueshme ndaj babait

Tri të lënduara në një aksident në Ferizaj, mes tyre edhe një foshnjë

Gjenden dy granata dore në një veturë në Prizren

Taboola Feed

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie

Blog | Sponsored Lexo më shumë

Qetësoni dhimbjen e kockave dhe të muskujve në kushte shtëpie

Blog | Sponsored Lexo më shumë

Abazoviq i bën thirrje Milatoviqit ta anulojë vendimin për shpalljen e zgjedhjeve

Kryeministri i Malit të Zi, Dritan Abazoviq, i ka bërë thirrje presidentit të ri Jakov Milatoviq, që ta anulojë vendimin e Milo Gjukanoviqit për shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme. …

Kohanet

Ja disa këshilla në lidhje me dhimbjen e kockave

Blog | Sponsored Lexo më shumë

TË TJERA

Sekuestrohen dy armë zjarri dhe një thikë në Prishtinë

31-vjeçarja nga Obiliqi dyshohet se bëri vetëvrasje me armë zjarri

Kameramanit i vidhen dy kamera, tripodi e monitori në Lipjan

Një person gjendet i vdekur në banesën e tij në Mitrovicë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.